



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 19.9.2023

Nr: 778

Ora: 09:00

VENDIM

PËR

**LIRIMIN DHE EMËRIMIN E DISA ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TË KZAZ NR. 11, PËR
ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të Vendimit nr. 35, datë 15.09.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N:

Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 35 datë 15.09.2023 ka vendosur që Partia Demokratike e Shqipërisë të jetë partia kryesore e opozitës parlamentare dhe të propozojë dy anëtarë, dhe Partia e Lirisë të jetë partia e dytë e opozitës parlamentare dhe të propozojë një anëtar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 775 datë 15.09.2023 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 722 datë 15.09.2023 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11 për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”, në zbatim të vendimit nr. 35/2023 të Kolegjit Zgjedhor ka caktuar që subjektet politike që kanë të drejtën e propozimit të anëtarëve të KZAZ-së, konkretisht:

- Dy anëtarë propozohen nga Partia Demokratike (PD),
- Një anëtar propozohet nga Partia e Lirisë (PL),
- Sekretari i KZAZ-së do të propozohet nga Partia Demokratike.

Partia Demokratike ka paraqitur kandidaturat për dy anëtarë dhe një sekretar të KZAZ-së nr. 11 dhe Partia e Lirisë ka paraqitur kandidaturën për një anëtar të KZAZ-së nr. 11.

Kandidaturat e paraqitura , plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “ d”, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Lirim nga detyra të anëtarit z. Flamur Hasan Sadria të KZAZ - së nr. 11, propozuar nga Partia e Lirisë. Emërimin në detyrë të anëtarit z. Halim Murat Gjani të KZAZ-së nr.11, propozuar nga Partia Demokratike.
2. Lirim nga detyra të sekretarit z. Shefki Idriz Shehu të KZAZ - së nr. 11, propozuar nga Partia e Lirisë. Emërimin në detyrë të sekretarit z. Shukri Abdullah Thaçi të KZAZ - së nr. 11, propozuar nga Partia Demokratike.
3. Lirim nga detyra të zv.kryetarit z.Taip Bajram Aliaj të KZAZ -së nr. 11. Emërimin në detyrë të anëtarit z. Taip Bajram Aliaj, të KZAZ-së nr. 11, të propozuar nga Partia e Lirisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzetë e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI